

VENDIM
Nr. 794, datë 9.11.2016

**PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË
BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE TRUALL”, TË PASURISË NR. 44/27, NË ZONËN
KADASTRALE 2636, BASHKIA FIER, TË PASURIVE NR. 64/25 DHE NR. 64/27, ZONA
KADASTRALE 3743, BASHKIA PATOS, TË PASURISË NR. 586/13, ZONA KADASTRALE
1724, BASHKIA LUSHNJË, DHE TË PASURISË NR. 20/1, ZONA KADASTRALE 3195,
BASHKIA BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të kategorisë së resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane truall”, të pasurisë nr. 44/27, në zonën kadastrale 2636, njësia administrative Mbrostar, Bashkia Fier, të pasurive nr. 64/25 dhe nr. 64/27, zona kadastrale 3743, njësia administrative Zharrës, Bashkia Patos, të pasurisë nr. 586/13, zona kadastrale 1724, njësia administrative Krutje, Bashkia Lushnjë, dhe të pasurisë nr. 20/1, zona kadastrale 3195, njësia administrative Roshnik, Bashkia Berat, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës përkatësisht në qarqet e Fierit e të Beratit të pasqyrojnë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e kategorisë së resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane truall”, të pasurisë nr. 44/27, zona kadastrale 2636, njësia administrative Mbrostar, Bashkia Fier, të pasurive nr. 64/25 dhe nr. 64/27, zona kadastrale 3743, njësia administrative Zharrës, Bashkia Patos, të pasurisë nr. 586/13, zona kadastrale 1724, njësia administrative Krutje, Bashkia Lushnjë, dhe të pasurisë nr. 20/1, zona kadastrale 3195, njësia administrative Roshnik, Bashkia Berat.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Fier, Këshilli i Qarkut Berat dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, Lushnjë e Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Sip. në m²	Vendndodhja	Bashkia	Lëshuar certifikata
1	44/27	2636	5000	Mbrostar	Fier	ZVRPP Fier
2.	64/25	3743	2400	Verbas	Patos	ZVRPP Fier
3	64/27	3743	4500	Verbas	Patos	ZVRPP Fier
4	586/13	1724	2000	Gjaze	Lushnjë	ZVRPP Lushnjë Certifikatë për dhënien me qira
5	20/1	3195	2100	Roshnik	Berat	ZVRPP Berat